

BASHKËPUNIMI I AKSP-SË ME ERASMUS+

Akademia e Kosovës për Siguri Publike që nga themelimi i Fakultetit të Sigurisë Publike në vjeshtë të vitit 2014 është mjaft aktive në programin Erasmus+, si në shkëmbimin e studentëve, stafit akademik dhe atij administrativ përmes Mobilitetit Ndërkombëtar të Kredive të këtij programi, po ashtu edhe në pjesëmarrje në ngjarjet që organizohen nga Zyra e Erasmus+ në Kosovë.

Kështu, nga viti 2016 e deri më tani, përmes Mobilitetit Ndërkombëtar të Kredive të programit Erasmus+, Akademia e Kosovës për Siguri Publike ka arritur të dërgojë jashtë vendit dhe të pranojë brenda vendit për qëndrime në periudha të ndryshme kohore gjithsej 105 studentë, pjesëtarë të stafit akademik e administrativ të AKSP-së dhe institucioneve partnere (përfshirë dhe zyrtarë të Policisë së Kosovës). Shkëmbimet janë zhvilluar në institucionet si në vijim: Akademia e Estonisë e Shkencave të Sigurisë, Universiteti i Shkencave të Aplikuara të Policisë në Brandenburg të Gjermanisë, Shkolla Kryesore e Shërbimit të Zjarrfikjes në Varshavë të Polonisë dhe Kolegji Universitar Policor i Norvegjisë.

Kështu, në Akademinë e Estonisë të Shkencave të Sigurisë (AESHS), gjatë katër viteve akademike, 2016 - 2017, 2017 - 2018, 2019 - 2020 dhe 2021 - 2022 janë dërguar nga 2 (dy) studentë në secilin vit akademik për të vijuar një semestër të tërë në periudhën kohore prej 5 (pesë) muajsh, përveç dy të fundit, që kanë qëndruar vetëm 4 (katër) muaj. Në të njëjtin institucion, në vitin akademik 2016 - 2017 kanë qëndruar për 2 (dy) javë për të dhënë mësim 2 (dy) mësimdhënës të Fakultetit të Sigurisë Publike (FSP) të AKSP-së. Në vitin akademik 2017 - 2018 1 (një) mësimdhënës e AKSP-së ka qëndruar për 1 (një) javë për mësimdhënie në AESHS dhe për të njëjtën periudhë kohore ka ardhur për të dhënë mësim edhe një mësimdhënës e EASHS-së në FSP të AKSP-së. Kurse në vitin akademik 2019 - 2020 kanë qëndruar 3 (tre) mësimdhënës për 1 (një) javë në këtë Akademi, ku kanë marrë pjesë në një konferencë shkencore. Për më tepër, në të njëjtin institucion kanë qëndruar 4 (katër) herë nga një grup për 1 (një) javë pjesëtarët e stafit administrativ të AKSP-së, dhe atë njëherë 2 (dy) pjesëtarë, herën e dytë 3 (tre) pjesëtarë, herën e tretë 1 (një) pjesëtar dhe herën e katërt 6 (gjashtë) pjesëtarë të stafit administrativ. Kurse në AKSP kanë qëndruar po ashtu njëherë 2 (dy) pjesëtarë të këtij institucioni, herën tjetër 1 (një) pjesëtar, herën e tretë 2 (dy) pjesëtarë dhe herën e katërt 5 (pesë) pjesëtarë tjerë të tij në AKSP, që të katër grupet për një javë. Për më shumë informata rreth AESHS, ju lutem klikoni: <https://www.sisekaitse.ee/en/eass-home>.

Në Universitetin e Shkencave të Aplikuara të Policisë në Brandenburg të Gjermanisë, për 1 (një) javë kanë qëndruar 4 (katër) grupe të zyrtarëve të Policisë së Kosovës me gjithsej 43 pjesëmarrës në një trajnim të dedikuar për ta. Në këtë institucion, në maj të vitit 2017 ka qëndruar një grup prej 15 zyrtarësh policorë, prej të cilëve 8 (tetë) studentë të FSP të AKSP-së, në dhjetor të vitit 2017 kanë qëndruar 3 (tre) zyrtarë policorë dhe në maj të vitit 2018 kanë qëndruar 17 zyrtarë policorë, prej të cilëve 9 (nëntë) studentë të FSP-së. Kurse në qershor të vitit 2019 kanë qëndruar 14 zyrtarë nga Kosova, prej të cilëve 8 (tetë) zyrtarë nga Policia e Kosovës të angazhuar në mësimdhënie në nivelin e trajnimit profesional dhe atë të arsimit të lartë, 4 (katër) mësimdhënës të Fakultetit të Sigurisë Publike (FSP) të AKSP-së dhe 2 (dy) zyrtarë të lartë të AKSP-së të përfshirë edhe në mësimdhënie në nivelin e trajnimeve profesionale. Për më tepër, në vitin akademik 2017 - 2018 në AKSP/Kosovë ka qëndruar 1 (një) mësimdhënës nga ky institucion. Për më shumë informata rreth Universitetit të Shkencave të Aplikuara të Policisë në Brandenburg, ju lutem klikoni: <https://www.fhpolbb.de/node/339>.

Në Shkollën Kryesore të Shërbimit të Zjarrfikjes në Varshavë të Polonisë janë zhvilluar 4 (katër) vizita njëjavore: në fund të shtatorit 2016 2 (dy) pjesëtarë të stafit administrativ, në maj 2018 nga 1 (një) zyrtar i stafit akademik dhe atij administrativ, në tetor 2018 1 (një) pjesëtar tjetër i stafit administrativ dhe në tetor 2021 2 (dy) pjesëtarë të stafit administrativ dhe 2 (dy) të tjerë të stafit akademik, prej të cilëve njëri ka qenë i angazhuar nga Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave (AME) e Kosovës. Për më shumë informata rreth SGSP, ju lutem klikoni: <https://www.sgsp.edu.pl>.

Në Kolegjin Universitar Policor të Norvegjisë (KUPN), në Oslo të Norvegjisë, gjatë vitit akademik 2021 - 2022 kanë qëndruar 2 profesorë të FSP-së së AKSP-së, dhe atë njëri në fund të prillit e tjetri në fund të majit 2022, si dhe 4 studentë të FSP të AKSP-së në fund të prillit 2022, që të gjithë në kohëzgjatje prej një jave. Përderisa në AKSP po ashtu për një javë, përkatësisht në javën e fundit të prillit 2022 ka qëndruar në AKSP një grup pre 3 (tre) mësime të këtij Kolegji. Për më shumë informata rreth KUPN, ju lutem klikoni: <https://www.politihogskolen.no/en/>.

	PERIUDHA KOHORE	NUMRI	INSTITUCIONI	LLOJI I SHKËMBIMIT
STAFI AKADEMIK	2 javë (2016 - 17)	2	Akademia e Estonisë e Shkencave të Sigurisë	Shkues
	1 javë (2017 - 18)	1	Universiteti Policor i Brandenburgut, Gjermani	Ardhës
	1 javë (2017 - 18)	1	Akademia e Estonisë e Shkencave të Sigurisë	Ardhës
	1 javë (2017 - 18)	1	Akademia e Estonisë e Shkencave të Sigurisë	Shkues
	1 javë (2017 - 18)	1	Shkolla Kryesore e Shërbimit të Zjarrfikjes, Poloni	Shkues
	1 javë (2018 - 19)	4	Universiteti Policor i Brandenburgut, Gjermani	Shkues
	1 javë (2019 - 20)	3	Akademia e Estonisë e Shkencave të Sigurisë	Shkues
	1 javë (2021 - 22)	2	Shkolla Kryesore e Shërbimit të Zjarrfikjes, Poloni	Shkues
	1 javë (2021 - 22)	1	Kolegji Universitar Policor i Norvegjisë	Shkues
	1 javë (2021 - 22)	3	Kolegji Universitar Policor i Norvegjisë	Ardhës
	1 javë (2021 - 22)	1	Kolegji Universitar Policor i Norvegjisë	Shkues
STUDENTËT	1 semestër (2016 - 17)	2	Akademia e Estonisë e Shkencave të Sigurisë	Shkues
	1 javë (2016 - 17)	8	Universiteti Policor i Brandenburgut, Gjermani	Shkues
	1 javë (2017 - 18)	9	Universiteti Policor i Brandenburgut, Gjermani	Shkues
	1 semestër (2017 - 18)	2	Akademia e Estonisë e Shkencave të Sigurisë	Shkues
	1 semestër (2019 - 20)	2	Akademia e Estonisë e Shkencave të Sigurisë	Shkues
	1 semestër (2021 - 22)	2	Akademia e Estonisë e Shkencave të Sigurisë	Shkues
	1 javë (2021 - 22)	4	Kolegji Universitar Policor i Norvegjisë	Shkues
STAFI ADMINISTRATIV	1 javë (2016 - 17)	2	Shkolla Kryesore e Shërbimit të Zjarrfikjes, Poloni	Shkues
	1 javë (2017 - 18)	2	Akademia e Estonisë e Shkencave të Sigurisë	Shkues
	1 javë (2017 - 18)	1	Shkolla Kryesore e Shërbimit të Zjarrfikjes, Poloni	Shkues
	1 javë (2018 - 19)	1	Shkolla Kryesore e Shërbimit të Zjarrfikjes, Poloni	Shkues
	1 javë (2018 - 19)	2	Akademia e Estonisë e Shkencave të Sigurisë	Ardhës
	1 javë (2018 - 19)	3	Akademia e Estonisë e Shkencave të Sigurisë	Shkues
	1 javë (2018 - 19)	1	Akademia e Estonisë e Shkencave të Sigurisë	Ardhës
	1 javë (2018 - 19)	2	Universiteti Policor i Brandenburgut, Gjermani	Shkues
	1 javë (2019 - 20)	1	Akademia e Estonisë e Shkencave të Sigurisë	Shkues
	1 javë (2019 - 20)	2	Akademia e Estonisë e Shkencave të Sigurisë	Ardhës
	1 javë (2021 - 22)	2	Shkolla Kryesore e Shërbimit të Zjarrfikjes, Poloni	Shkues
	1 javë (2021 - 22)	5	Akademia e Estonisë e Shkencave të Sigurisë	Ardhës
	1 javë (2021 - 22)	6	Akademia e Estonisë e Shkencave të Sigurisë	Shkues
ZYRTARËT E POLICISË SË KOSOVËS	1 javë (2016 - 17)	7	Universiteti Policor i Brandenburgut, Gjermani	Shkues
	1 javë (2017 - 18)	3	Universiteti Policor i Brandenburgut, Gjermani	Shkues
	1 javë (2017 - 18)	8	Universiteti Policor i Brandenburgut, Gjermani	Shkues
	1 javë (2018 - 19)	8	Universiteti Policor i Brandenburgut, Gjermani	Shkues
GJITHSEJ		105		

Tabela 1: Aktivitetet e Mobilitetit Ndërkombëtar të Kredive (MNK) të Erasmus+të AKSP-së

Përderisa po ashtu zyrtarë nga stafi akademik dhe administrativ i AKSP-së kanë marrë pjesë në gjithsej 15 aktivitete dhe ngjarje të organizuara nga Zyra e Erasmus+ në Kosovë, dhe atë në 5 Ditët Informuese për vitet 2014, 2015, 2016, 2017 dhe 2018, në Seminarët e Ekspertëve të Reformës së Arsimit të Lartë (HERE) dhe në ngjarje të tjera.

NR.	EMRI I NGJARJES	DATA(T) E MBAJTJES
1.	Dita Informuese 2014	12.11.2014
2.	Semiar i Ekspertëve të Reformës së Arsimit të Lartë (HERE) në Kosovë “Roli i studentëve në reformat e arsimit të lartë në Kosovë”	16.12.2014
3.	Semiar i Ekspertëve të Reformës së Arsimit të Lartë (HERE) në Kosovë “Ndërkombëtarizimi dhe Mobiliteti”	04.06.2015
4.	Seminari Kontakti i Erasmus+ në Ballkanin Perëndimor për vendet Nordike dhe Baltike	05.11.2015
5.	Dita Informuese 2015	24.11.2015
6.	Seminari i Ekspertëve të Reformës së Arsimit të Lartë (HERE) në Kosovë “Dimensioni profesional në arsimin e lartë”	22.11.2015
7.	Seminari "Mësimi elektronik dhe përgatitja e moduleve elektronike"	17.09.2016
8.	Dita Informuese 2016	12.10.2016
9.	Tryeza e diskutimit me temën “Iniciativat institucionale për të nxitur mësimdhënien cilësore në arsimin e lartë”	07.12.2016
10.	Semiar i Ekspertëve të Reformës së Arsimit të Lartë (HERE) në Kosovë “Cilësia në bashkëpunimet ndërkombëtare”	08.02.2017
11.	Seminar trajnues “Si të përgatitet projekti konkurrues në Ndërtimin e Kapaciteteve në Arsimin e Lartë (CBHE) në kuadër të Programit Erasmus+”	25 - 26.09.2017
12.	Dita Informuese 2017	07.11.2017
13.	Semiar i Ekspertëve të Reformës së Arsimit të Lartë (HERE) në Kosovë "Ndërkombëtarizimi i Arsimit të Lartë - Praktikat më të mira"	14.12.2017
14.	Semiar i Ekspertëve të Reformës së Arsimit të Lartë (HERE) në Kosovë “Transformimi i Universiteteve nëpërmjet digjitalizimit dhe aplikimit të metodave të duhura”	28.05.2018
15.	Dita Informuese 2018	26.11.2018
16.	Seminar Kontakti i Erasmus+ me Ballkanin Perëndimor	24 - 26.10.2019
17.	Dita Informuese 2019	28.10.2019
18.	Promovimi i hapjes së Këndit të Erasmus+	11.11.2019

Tabela 2: Ngjarjet e Zyrës së Erasmus+ në Kosovë ku kanë marrë pjesë zyrtarët nga AKSP

Për më tepër, zyrtarët nga Zyra e Erasmus+ në Kosovë kanë vizituar disa herë AKSP-në

NR.	EMRI I NGJARJES	DATA(T) E MBAJTJES
1.	Vizita e Zyrës së Erasmus+ në AKSP	07.03.2017
2.	Vizita e Zyrës së Erasmus+ në AKSP	05.12.2018
3.	Vizita e Zyrës së Erasmus+ në AKSP në monitorimin e MNK (ICM)	27.02.2019
4.	Trajnim për Mobilitetin Ndërkombëtar të Kredive (ICM) dhe Ndërtimin e Kapaciteteve në Arsimin e Lartë (CBHE) nga Zyra e Erasmus+ në Kosovë mbajtur në AKSP	25.03.2019
5.	Sesion Informues i Zyrës së Erasmus+ në Kosovë	31.01.2020
6.	Vizita e Zyrës së Erasmus+ në AKSP	27.06.2022

Tabela 3: Vizitat e Zyrës së Erasmus+ në Kosovë në AKSP